

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18, dhe 208/24) dhe duke vepruar në bazë të njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Ana Marojeviq (Ana Marojević), shtetase e Malit të Zi, XXX, Menzies Aviejshn (Jurop) BV. (Menzies Aviation (Europe) BV), me seli në Anchorageaan 50, 1118 Shiphol, Holandë dhe Air SERBIA a.d. Beograd (Air SERBIA ad. Beograd), me selinë të regjistruar në Jurija Gagarina 12, Beograd-Nov Beograd, Republika e Serbisë, përmes Shoqërisë së Avokatëve Polenak nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 18.10.2024, solli

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me Ana Marojeviq (Ana Marojević), shtetase e Malit të Zi, XXX, Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. (Menzies Aviation (Europe) B.V.), me seli në Anchorageaan 50, 1118 Shiphol, Holandë dhe Air SERBIA a.d. Beograd (Air SERBIA ad. Beograd), me selinë të regjistruar në Jurija Gagarina 12, Beograd-Nov Beograd, Republika e Serbisë, *synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët direkt mbi MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURČIN (MENZIES AVIATION DOO BEOGRAD-SURČIN)*, me seli në Aeroportin Nikola Tesla, Zyra nr. 3, lidhur me Terminalin 1, Surčin, Republika e Serbisë, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 20.08.2024, e plotësuar më 16.09.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga Ana Marojeviq, shtetase e Malit të Zi, XXX Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. (Menzies Aviation (Europe) B.V.), me seli në Anhoragelaan 50, 1118 Shiphol, Holandë dhe Air SERBIA a.d. Beograd (Air SERBIA ad. Beograd), me selinë të regjistruar në Juriya Gagarina 12, Beograd-Nov Beograd, Republika e Serbisë, me të cilën Ana Marojevic, Mali i Zi, Menzies Aviejshn (Jurop) B.V., Holandë dhe Air SERBIA a.d. Beograd, Republika e Serbisë synojnë të fitojnë kontroll të përbashkët direkt mbi MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN (MENZIES AVIATION DOO BEOGRAD-SURČIN), me seli në Aeroportin Nikola Tesla, Zyra nr. 3, lidhur me Terminalin 1, Surçin, Republika e Serbisë me anë të transferimit të pjesës.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim, shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Ana Marojeviq është një person fizik me vendbanim në Mal të Zi dhe partner në Menzies Serbi.

Ana Marojeviq nuk ka shoqëri të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Aktiviteti kryesor i **Menzies Aviejshn(Jurop) B.V.** është ofrimi i shërbimeve të sigurta dhe efikase të aviacionit (shërbimet e transportit tokësor) dhe shërbime të transportit ajror. Menzies Aviejshn (Jurop) B.V., është shoqëria udhëheqëse e biznesit evropian, me qendër në Amsterdam, që ofron shërbime aeroporti, si sipër ashtu edhe poshtë krahut, duke siguruar që pasagjerët, ekuipazhi dhe avionët të kryejnë udhëtimet e tyre në mënyrë efikase dhe të menjëhershme. Menzies Aviejshn (Jurop) B.V., operon gjithashtu transportin global të ngarkesave me vlerë të lartë dhe ngarkesave të dërgesave emergjente. Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. ka dekada përvojë, e mbështetur nga zgjidhje logjistike efikase dhe inteligjente, që do të thotë se atyre u besohet të ofrojnë një shërbim të besueshëm dhe të sigurt.

Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. është pjesë e Grupit të shoqërive Menzies Aviejshn, të udhëhequr nga shoqëria holding Xhon Menzies Limited (John Menzies Limited) nga Mbretëria e Bashkuar ("Menzies Group"), e cila është pjesë e grupit Agiliti Pablik Verehause Kompani K.S.C.P (the Agility Public Warehousing Company K.S.C.P. group). Menzies Group ofron shërbime të transportit tokësor të aeroportit, mallrave, furnizim me karburant dhe shërbime të tjera për klientët e aeroportit dhe transportuesit në mbarë botën.

Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. nuk ka shoqëri të regjistruara të lidhura në Maqedoninë e Veriut.

Aktiviteti i regjistruar i **Air SERBIA a.d. Beograd** është një transport ajror pasagjerësh. Air SERBIA a.d. Beograd gjithashtu transporton sasi të mëdha mallrash dhe poste në fluturimet e tij të rregullta si pjesë integrale e biznesit të tij.

Air SERBIA ad. Beograd është linja ajrore kombëtare e Republikës së Serbisë, një ndjekës ligjor i linjës së parë ajrore kombëtare, Aeroput, e themeluar në Beograd në 1927. Air SERBIA a.d. Beograd funksionon me emrin aktual që nga tetori 2013. Air SERBIA a.d. Beogradi operon fluturime të planifikuara, sezonale dhe çarter në mbi 70 destinacione në Evropë, Mesdhe, Amerikën e Veriut, Azi dhe Afrikë, në trafikun e pasagjerëve dhe mallrave. Në bashkëpunim me partnerët e tyre të linjës ajrore, Air SERBIA a.d. Beograd gjithashtu ofron fluturime drejt destinacioneve ndërkombëtare në Azi, Australi, Amerikën e Veriut dhe Afrikë. Air SERBIA a.d. Beograd është gjithashtu anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA).

Air SERBIA a.d. Beograd ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria e Trafikut Ajror AEROMAK SHPKNJ Shkup, me seli të regjistruar në bul. Partizanski odredi nr.17, Shkup, Maqedonia e Veriut me aktivitet AEROMAK SHPKNJ Shkup 51.10 - transport ajror pasagjerësh.

Aktiviteti i regjistruar i **MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN** është 5223 - aktivitete shërbimi në trafikun ajror.

MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN nuk ka asnjë shoqëri të lidhur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска